

FTESE PER OFERTE

I/E nderuar Zoteri/Zonje,

1. Ju jeni te lutur te paraqitni oferten tuaj per **“Furnizim dhe mirembajtje per produkte sigurie Bankare”** per nevoja te Tirana Bank.
*Per informacion me te detajuar ju lutem shikoni **Anekset A, B, C, D dhe E** bashkengjitur.*

2. Ju mund te jepni oferten Tuaj per sherbimin e lartpermendur, per te cilat do te kete procedure vleresimi dhe do te lidhet kontrate me ofertuesin/ofertuesit me te mire. {Ju mund te paraqisni oferten tuaj duke u bazuar ne FTESEN PER OFERTE}.

3. Oferta Juaj duhet te dergohet ne zarf te mbyllur. Siper zarfit duhet te shenoni emrin e kompanise dhe titullin e tenderit ne te cilin do merrni pjese, dhe ta dergoni ne adresen:

Njesia e Prokurimit

Tirana Bank, Zyrat Qendrore

*Bulevardi “Zhan D'Ark”, Njesia Administrative nr. 2, Godina “MET Tirana Building”,
Tirane*

4. **Afati i fundit i pranimit te ofertave** eshte:
30.04.2026

5. Detajet:

- **Ky tender perfshin Furnizim dhe mirembajtje per produkte sigurie Bankare per nevoja te Tirana Bank si me poshte:**

- a. Ofrimi i sherbimeve per mirembajtjen periodike dhe riparuese per pajisjet:
 - Lampa kontrolli cdo gjashte muaj
 - Makina shirituese cdo gjashte muaj
 - Tabela exchange cdo gjashte muaj
 - Kode elektroike dhe mekanike (Time Delay) cdo gjashte muaj
 - Makine numerimi kartemonedhash me 2-xhepa NC-7100 cdo tre muaj.

- b. Furnizimi me materiale te ndryshme si:
 - kode eletronike dhe te thjeshta mekanike me celes,
 - brava mekanike per Kasaforta Qendrore, Kasaforta Ditore dhe ATM,
 - thase per transportin e fondeve,
 - siguresa per thase fondesh dhe ATM,
 - qese per monedha,
 - bateri 9V per time delay etj.

Afati per fillimin e sherbimit dt 31.07.2026.

- c. Kontrate bashkepunimi ‘Blerja dhe instalimi i makinave te numerimit me dy xhepa, si dhe ofrimi i sherbimeve per mirembajtjen periodike dhe riparuese te tyre.

Afati per fillimin e sherbimit dt 31.07.2026.

- d. Kontrate bashkepunimi ‘Blerje Kasaforta Ditore KORAL EK1500’.

Afati per fillimin e sherbimit dt 30.11.2026.

- Specifikimet teknike, jepen ne Aneksin A dhe B.
 - Sasia aktuale e pajisjeve per cdo dege sipas Aneksit C.
- Anekset A, B dhe C bashkengjitur.



6. Cmimet

Ju do te paraqisni oferten tuaj financiare (sipas Aneksit B) si me poshte:

A. Kosto per sherbimin e mirembajtjes. Kjo kosto do te jete fikse dhe duhet te perfshije:

a. Kosto Vjetore per Mirembajtjen Periodike

Vlerat e sherbimit te mirembajtjes perfshijne:

- Sherbim mirembajtje llampa kontrolli cdo gjashte muaj.
- Sherbimi mirembajtje makina shirituese cdo gjashte muaj.
- Sherbimi mirembajtje Tabela Exchange cdo gjashte muaj.
- Sherbim mirembajtje kode elektronik dhe mekanik (Time Delay) cdo gjashte muaj.
- Sherbim mirembajtje makine numerimi kartemonedhash me 2-xhepa NC-7100 cdo tre muaj.
Nese makina ka nevojte per tu derguar ne laborator kompania duhet ta zevendesoje me nje makine tjetere te njejte brenda 24 oresh ne Tirane dhe brenda 24-48 oresh ne rrethe.

Jepni dhe frekuencen e pageses dhe termat e pageses

Ne cmimin e Mirembajtjes Periodike, duhet te jene te perfshira, pervec sherbimeve ne piken a, edhe:

- ✓ Pjeset e nderrimit qe do te nevoiten.
- ✓ Te gjitha axhustimet e sensoreve.
- ✓ Ndryshimet e kodeve deri ne 200 vizita ne vit.
- ✓ TVSH, transporti, cdo shpenzim stafi, cdo takse dhe tatim.
- ✓ Instalimi, c'instalimi

b. Kosto per rast per Mirembajtjen riparuese/on call, sipas kerkeses per te gjitha pajisjet.

B. Kosto per rast ne dege per Hapje te sforcuar te kasafortave Ditore dhe Qendrore, brenda dhe jashte Tirane.

C. Kosto per nderrim kodesh vetem nese kalon numrin e 200 vizitave ne dege per nderrim kodesh (brenda dhe jashte Rajonit Tirane)

- Kjo kosto qe do te perdoret vetem pasi te plotesohet numrin i 200 vizitave ne dege ne vit. Kjo do te thote se deri ne 200 vizita per dege jane falas (te perfshire ne koston e mirembajtjes me lart)

D. Kosto per njesi per Pajisjet e reja si meposhte, sipas nevojave te Bankes:

- Kode Elektronik per Kasaforta Ditore, Qendrore dhe ATM
- Kode te thjeshta mekanike per Kasaforta Ditore, Qendrore dhe ATM
- Makine numerimi kartemonedhash me 2-xhepa BPM, modeli NC-7100 ose etj.
- Kasaforta Ditore Koral
- Kasaforte Qendrore VDS
- Marrje mbrapsh e Kasafortave Ditore te vjetra qe ka Banka.
- Tabela Exchange (ekran nga nje ane ose te dy anet)
- Brava mekanike me celes per Kasaforta Ditore, Qendrore dhe ATM.
- Thase Lecke (gjat 80 cm, gjer: 50 cm, mbyllja me percina me rrathe nr. percinave 10)
- Lidhese sigurie me numer serial per thase te transportit monetar (gjat: 430 mm, gjer: 6mm)
- Qese per monedha metalike B5, (gjat: 195mm, gjer: 280mm)
- Lidhese sigurie me numer serial per ATM-s, (gjat: 430mm, gjer: 3mm)
- Makine shirituese kartemonedhash e vogel
- Makine shirituese kartemonedhash e madhe
- Shirit Plastik per makinat shirituese (gjat: 4000 mt, gjer: 8-9mm) ngjyra blu ose e bardhe, (e printuar ose jo) per makinat ekzistuese
- Leter speciale per makinat e reja shirituese te kartemonedhave (sipas specifikimeve ne pikat 13-14).
- Llamba kontrolli UV (Ultra Violet)
- Bateri 9 Volt-she

Vlerat e mesiperme duhet te perfshijne:

- Transportin



- TVSH, cdo takse apo tatim
- Instalim, ç'instalim
- Shpenzim stafi (Kohe punëtori, Shpenzime dieta, hoteleri)

Përvec sa sipër:

Per makinat e numerimit te kartemonedhave NC-7100 kosto per njesi duhet te perfshije: trajnimi i punonjesve te Bankes, manual perdorimi ne gjuhen shqipe, suport on-line.

Per tabelat exhchange kosto per njesi perfshin telekomanda/programimi sipas kerkeses nga Banka.

Ju duhet te paraqitni Termat e pageses ne lidhje me termat e kryerjes se sherbimit dhe levrimit te mallit.

Çmimet do te mbeten te pandryshuara gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates.

Pershkrim i detajuar jepet ne aneksin A dhe B. Plotesoni Aneksin B me oferten tuaj financiare.

7. Garancia dhe Afati levrimit te kerkuara nga Banka:

1. **Garancia:**

Materialet qe do te perdoren do te jene te reja, origjinale, sipas standarteve dhe specifikimeve teknike te kerkuara nga Banka.

Garancise te kerkuar nga Banka:

- Garancia e pajisjeve te reja kode elektronike, mekanike te jete minimum 1 vit.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per punen e kryer te jete: jo me pak se 6 muaj nga dita e venies ne pune.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per makinat e numerimit te kartemonedhave NC-7100: minimumi 2-dy vite nga venia ne pune.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per Kasafortat Ditore kosto per njesi perfshin TVSH, instalimin, transportin sipas kerkeses nga Banka: 3 vite.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per tabelat exhchange: 1-2 vite.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per Kasafortat Qendrore: minimumi 3 vite.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per makinat shirituese e vogel/e madhe: 1-2 vite.
Ofruar nga ju: _____

2. **Koha e pergjigjes per Mirembajtjen On-call:**

Prezenca ne dege pas njoftimit me telefon/email, kerkuar nga Banka:

- Brenda 24 oresh per deget ne Tirane.
Ofruar nga ju: _____
- Brenda 48 oresh per deget ne Rrethe. Afati i pergjigjes deri 48 ore i referohet kohes maksimale per nderhyrje nga momenti i raportimit te problemit per deget ne rrethe. Ky interval eshte percaktuar duke marre ne konsiderate distancen dhe logjistiken. Ne raste specifike, kur natyra e problematikes e kerkon dhe eshte e mundur operacionalisht, nderhyrja mund te realizohet ne nje kohe me te shkurtër.
Ofruar nga ju: _____

3. **Afati i dorezimit te produkteve pas njoftimit nga Banka:**

Kerkuar nga Banka:

- Afati i dorezimit te produkteve per materialet thase fondesh, siguresa fondesh, siguresa ATM etj: 2-3 jave nga momenti i njoftimit.
Ofruar nga ju: _____
- Afati i dorezimit per makinat e numerimit te kartemonedhave NC-7100: 1-2 muaj.
Ofruar nga ju: _____



- Afati i dorezimit per Kasafortat Ditore: 3-6 jave.
Ofruar nga ju: _____
- Afati i dorezimit per tabelat exhchange: 1-3 muaj.
Ofruar nga ju: _____
- Afati i dorezimit per Kasafortat Qendrore: 1-3 muaj.
Ofruar nga ju: _____
- Afati i dorezimit per makinat shirituese e vogel/e madhe: 1-3 muaj.
Ofruar nga ju: _____

Plotesoni Aneksin D bashkangjitur

8. Oferta Juaj duhet permbaje dokumentacionin e meposhtem:

A. Dokumentacion teknik dhe ligjor:

- Fotokopje e certificates se regjistrimit si person i tatueshem nga organi perkates.
- Kopje e ekstraktit te printuar nga e-albania te Regjistrimit tregtar nga QKR brenda muajit te fundit.
- CV e kompanise.
- Klientet per punime te njejta apo te ngjashme me ate te kerkuar.
- Leter Reference per bashkepunim relevant me institucione/kompani private (te pakten dy).

B. Formulari vigjilences: Plotesoni, firmosni dhe vulosni formatin bashkengjitur emailit.

9. Detajet e kontrates:

Kohezgjatja: 2 vite. Kontrata do të shtyhet automatikisht me të njëjtat kushte dhe për 1 (një) vit tjetër nëse Banka nuk kërkon me shkrim përfundimin e kontrates 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit.

Draft kontrata sipas Aneksit E Bashkangjitur

10. Per informacione te metejshme ju mund te kontaktoni me:

E-mail: procurement@tiranabank.al

11. Ju lutem konfirmoni ne e-mailin e sipershenuar marrjen e kesaj ftese dhe nese ju pranoni te merrin pjese ne kete procedure prokurimi.

12. Ne vemendjen tuaj: Pagesat per kompanine/te fituese per procesin e prokurimit do te behen nepermjet llogarise ne Banken Tirana dhe ne rast se nuk ka mundesi per te hapur nje llogari ne Banken Tirana, komisionet e transferimit do t'i ngarkohen kompanise.

Sinqerisht,
BANKA TIRANA



ANEKSI A: SHERBIMET E MIREMBAJTJES PERIODIKE DHE ON-CALL DHE CMIMET

A. Mirembajtje periodike

1. Sherbim mirembajtje llampa kontrolli (dedector)

Sherbimi i mirembajtjes do te perfshije sherbimet si me poshte:

- Sherbim mirembajtje i plote (periodik dhe riparues).
- Sherbimi do jete periodik dhe do te kryhet **1 here ne 6 muaj**.
- Pjeset e nderrimit qe do te nevojiten, llampa etj do te jene te perfshira ne cmim.
- Sherbimi do te kryhet ne deget e bankes on site.
- Ne rastin kur nevojitet qe pajisja llampe kontrolli te shkoje ne laboratorin e kompanise per riparim, kompania do te ofroje pajisje llampe kontrolli zevendesuese te njejte ose te perafert me ate qe do marri per riparim.
- Transporti do do jete i perfshire ne cmim.

2. Sherbim mirembajtje makina shirituese

Sherbimi i mirembajtjes se makinave shirituese do te perfshije sherbimet si me poshte:

- Sherbim mirembajtje i plote (periodik dhe riparues).
- Sherbimi do jete periodik dhe do te kryhet **1 here ne 6 muaj**.
- Pjeset e nderrimit qe do te nevojiten do te jene te perfshira ne cmim.
- Sherbimi do te kryhet ne deget e bankes on site.
- Te gjithë pjeset e nderrimit te nevojshme do te jene te perfshira ne cmim.
- Transporti do jete i perfshire ne cmim.

3. Sherbim mirembajtje Tabela Exchange ekzistuese dhe te reja

Sherbimi i mirembajtjes se Tabelave Exchange do te perfshije sherbimet si me poshte:

- Sherbim mirembajtje i plote (periodik dhe riparues).
- Sherbimi do jete periodik dhe do te kryhet **1 here ne 6 muaj**.
- Pjeset e nderrimit qe do te nevojiten do te jene te perfshira ne cmim.
- Sherbimi do te kryhet ne deget e bankes on site.
- Te gjithë pjeset e nderrimit te nevojshme do te jene te perfshira ne cmim.
- Transporti do jete i perfshire ne cmim.

4. Sherbim mirembajtje kode elektronik dhe mekanik (Time Delay)

Sherbimi i mirembajtjes (periodik dhe riparues) se Kodeve Elektronik dhe mekanik do te perfshije sherbimet si me poshte:

- Sherbim mirembajtje axhustim, pastrim, regjistrim, nderrim kodi.
- Sherbimi do jete periodik dhe do te kryhet **1 here ne 6 muaj**.
- Sherbimi do kryhet ne deget e bankes on site.
- Ne rast demtimi te kodit kompania do ta zevendesoje me kode te ri sipas modelit te perzgjedhur me pare dhe te ofertuar me vete nga ky sherbim.

5. Sherbim mirembajtje makina numerimi me 2-xhepa

- Sherbimi i mirembajtjes i plote (periodik dhe riparues).
- Sherbimi do jete periodik dhe do te kryhet **1 here ne 3 muaj**.
- Sherbimi do kryhet ne deget e bankes (on-site).
- Nese makina ka nevojte per tu derguar ne laborator kompania duhet ta zevendesoje me nje makine tjeter te njejte brenda 24 oresh ne Tirane dhe brenda 24-48 oresh ne rrethe.
- Parandalimi i defekteve dhe axhustimet e sensoreve.
- Pjeset e nderrimit qe do te nevojiten do te jene origjinale dhe te perfshira ne cmim.
- Transporti do jete i perfshire ne cmim.
- Up-date te software per prerjet ekzistuese dhe te reja, si dhe kartmonedhat fallco do jete e perfshire ne cmim.
- Sherbim online per stafin e Bankes nga e Hena ne te Premte 08:00-17:00, dhe ditën e shtune 08:00 – 14:00.
- Riparimi i problemit: brenda 24 oresh ne Tirane dhe brenda 24-48 oresh ne rrethe.

B. Mirembajtje riparuese

Mirembajtja riparuese do te perfshije:

- Riparimin e problemeve, apo demtimeve.
- Kryerjen e punimeve te mundeshme, sipas kerkesave nga Banka.
- Riparimi i problemit: brenda 24 oresh ne Tirane dhe brenda 24-48 oresh ne rrethe.

C. Ndryshim i kodeve kur kerkohet nga Banka

- Ndryshimi i kodeve do te kryhet sipas kerkesave nga Banka.



ANEKSI B – KOSTO DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

1 - MIREMBAJTJA PERIODIKE DHE ON CALL (CMIMI NE ALL / TVSH PERFSHIRE)		
Kosto per sherbimin e mirembajtjes periodike ne te gjitha objektet e Tirana Bank ne Shqiperi	Cmimi Vjetor	
Sherbim mirembajtje llampa kontrolli cdo gjashte muaj		
Sherbimi mirembajtje makina shirituese cdo gjashte muaj		
Sherbimi mirembajtje Tabela Exchange cdo gjashte muaj		
Sherbim mirembajtje kode elektronik dhe mekanik (Time Delay) cdo gjashte muaj		
Sherbimi mirembajtje makine numerimi kartemonedhash me 2-xhepa NC-7100 cdo tre muaj	Sasia	Kosto/makine
	80-99 makina	
	> 100 makina	
Kosto per nderrim kodesh brenda Rajoni Tirane	Cmimi Vizite/Dege	
Deri ne 200 vizita ne vit per ndërrim kodesh ne te gjitha degët, sipas kërkesave nga Banka (pavaresisht numrit te kodeve qe do nderrohen ne nje dege) nuk do kete kosto.	Perfshire ne çmimin e Mirembajtjes Periodike	
Pas 200 vizitave, kostoja do jete per vizite per dege (pavaresisht numrit te kodeve qe do nderrohen ne nje dege) .		
Kosto per nderrim kodesh, jashte Rajonit Tirane	Cmimi Vizite/Dege	
Deri ne 200 vizita ne vit ne te gjitha deget e kerkuara nga Banka (pavaresisht numrit te kodeve qe do nderrohen ne nje dege) nuk do kete kosto.	Perfshire ne çmimin e Mirembajtjes Periodike	
Pas 200 vizitave kostoja do jete per vizite per dege (pavaresisht numrit te kodeve qe do nderrohen ne nje dege).		
Kosto e Mirembajtjes On-Call sipas kërkeses per te gjitha pajisjet.	Kosto per rast (perfshire transport)	
On call, brenda Rajoni Tirane		
On call, jashte Rajonit Tirane		
Kosto per Hapje e sforcuar	Kosto per rast (perfshire transport)	
Hapje e sforcuar Kasaforte Ditore , brenda Rajoni Tirane		
Hapje e sforcuar Kasaforte Qendrore, brenda Rajoni Tirane		
Hapje e sforcuar Kasaforte Ditore, jashte Rajonit Tirane		
Hapje e sforcuar Kasaforte Qendrore, jashte Rajonit Tirane		
Shenime:		
Vlerat e sherbimit te mirembajtjes perfshijne:		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Mirembajtjen Periodike si me poshte: <ol style="list-style-type: none"> a. Sherbim mirembajtje llampa kontrolli cdo gjashte muaj. b. Sherbimi mirembajtje makina shirituese cdo gjashte muaj. c. Sherbimi mirembajtje Tabela Exchange cdo gjashte muaj. d. Sherbim mirembajtje kode elektronik dhe mekanik (Time Delay) cdo gjashte muaj. e. Sherbim mirembajtje makine numerimi kartemonedhash me 2-xhepa NC-7100 cdo tre muaj. 2. Pjeset e nderrimit qe do te nevoiten do te jene te perfshira ne cmim. 3. Te gjithe axhustimet e sensoreve do te jene te perfshira ne cmim. 4. Ndryshimet e kodeve deri ne 200 vizita ne vit. 5. TVSH, transporti, cdo shpenzim stafi, cdo takse dhe tatim 6. Instalim, c’instalim. 		



2 - PAJISJE TE REJA	
Pershkrimi	Cmim/Njesi
<p>1. Kode Elektronik per Kasaforta Ditore, Qendrore dhe ATM Tastiera: Touch screen SCRAMBLED Ka mundesi qe 1 tastier te lidhet me 15 brava ne te ardhmen. Brava: E motorizuar 32 bit microprocesor Perdorues: 1 Master, 2 Managers, 90 users, 10 override users Time Delay: 1 - 99 sekonda Open window: 1 - 99 sekonda Hapja: E kombinuar me 2 Users per hapje Ora, Data: Ruhet ne kodin elektronik dhe te kete mundesi leximi te eventeve Memorie: 800 evente kronologjike Programimi: Nga tastiera apo kompjuteri Ka kod emergjence ne rast bllokime apo mosfunksionimi dhe te jepet vetem nga kompania prodhuese. Ka mundesi per lidhje me PC dhe te shkarkohen ne Program. Ka mundesi per lidhje ne rrjetin e Bankes ne te ardhmen dhe monitorim nga Qendra Operative.</p>	
<p>2. Kode te thjeshta mekanike per Kasaforta Ditore, Qendrore dhe ATM Tastiera: Display (Ekran) Ka mundesi qe 1 tastiere te lidhet me 15 brava ne te ardhmen. Brava: E motorizuar Perdorues: Master, 1 Managers, 8 users, 10 override users Time Delay: 1 - 99 sekonda Open window: 1 - 99 sekonda Hapja: E kombinuar me 2 Users per hapje Ora, Data: Ruhet ne kodin elektronik dhe te kete mundesi leximi te eventeve Memorie: 2000 evente kronologjike Programimi: Nga tastiera apo kompjuteri Ka kod emergjence ne rast bllokime apo mosfunksionimi dhe te jepet vetem nga kompania prodhuese. Ka mundesi per lidhje me PC dhe te shkarkohen ne Program. Ka mundesi per lidhje ne rrjetin e Bankes ne te ardhmen dhe monitorim nga Qendra Operative.</p>	
<p>3. Makine numerimi kartemonedhash me 2-xhepa BPM, modeli NC-7100 ose etj. Valutat e pranueshme: USD (United States Dollar); EUR (European Union) GBP (Great Britain Pound); Monedha lokale (Opsionale): Deri ne 9 valuta te ndryshme. Fuqia e Hopperit: 500 bankonota Kapaciteti i xhepave: Xhepat kryesore 250 bankonota; Xhepi refuzues maksimumi 100 bankonota. Shpejtesia e numerimit: 1100-1500 bankonota per 1 minute Ekрани: 3.5 inch me ngjyra TFT Ushqimi: 100/240V AC, 50/60Hz ; Konsumimi: 150W Lidhjet: LAN - 1 hyrje; RS232 – 2 hyrje; USB – 1 hyrje;SD CARD – 1 hyrje Kapja e banknotave fallco: Dual CIS; Reflektim dhe transmetim me Infra te Kuqe; Manjetike; Sensor trashesie; Ultra Violet Makinat e numerimit duhet te garantojne: zbulimin dhe vecimin e kartemonedhave fallco ne cdo valute, zbulimin e kartemonedhave te demtuara, te bojatisura, zbulimin e kartemonedhave dopio seri, zbulimin e kartemonedhave te ngjitura, numerim vlera mikse, certifikim nga BSH dhe ECB (te paraqesin certifikaten). Kosto per njesi duhet te perfshije: Instalim, transport, TVSH, shpenzime stafi, trajnimi i punonjesve te Bankes, manual perdorimi ne gjuhen shqipe, suport on-line.</p>	
<p>4. Kasaforta Ditore Koral <u>Specifikimet teknike:</u> a. Dimensionet: Thellesia 680mm x Gjeresia 480mm x Gjatesia 580mm, Sirtare: 3-4(te bllokueshme nga kodi elektronik ose mekanik)</p>	



<p>3+1 me hapje nga kod elektronik i instaluar ne trupin e Kasafortes. Te 4 sirtaret happen duke shtypur 1ENTER2ENTER e keshtu me radhe. Sirtari i 3 mund te vendosim kohe vonese (ne varesi te kerkeses). Gjithashtu eshte i lidhur me nje sirtar te vogel qe sherben per te futur mansetat e lekeve pa e hapur sirtarin e 3 gje e cila krijon fasilitet, shpejtesi dhe siguri gjate punes.</p> <p>Pesha: 80-100 kg</p> <p>b. Kodi elektronik (me ekran display) me bateri ose korent dhe me kohe vonese hapje deri ne 10 (dhjete) perdorues.</p> <p>Eshte i instaluar ne trupin e Kasafortes sebashku me display dhe numratorin per formimin e kodit. Kasaforta ka bateri te jashtme te instaluar ne trup e cila suporton ne rastet e shkeputjes se energjise. Gjithashtu Kasaforta nuk mund te hapet pa futur celesin dhe kthyer nga ON, ne momentin qe arketari largohet nga vendi i punes kthen celsin nga OFF dhe e terheq.</p> <p>c. Kodi mekanik (me celes, minimalisht 2 (dy) celesa)</p> <p>d. Cilesia e pajisjeve te jene te reja.</p> <p>Kosto per njesi duhet te perفشije TVSH, instalimin, transportin sipas kerkeses nga Banka.</p>	
<p>5. Kasaforte Qendrore VDS</p> <p>Certifikate BE dhe VDS.</p> <p>Permasat: 160/140x50/60x40/50.</p> <p>Pesha: Min 750kg.</p> <p>Grada e sigurise: 2 – 4 .</p> <p>Kodi elektronik (me ekran display) me bateri ose korent dhe me kohe vonese , hapje deri ne 10 (dhjete) perdorues.</p> <p>Kodi mekanik (me celes, minimalisht 2 (dy) celesa)</p> <p>Cilesia e pajisjeve te jene te reja.</p> <p>Kosto per njesi duhet te perفشije TVSH, instalimin, transportin sipas kerkeses nga Banka.</p>	
<p>6. Marrje mbrapsh e Kasafortave Ditore te vjetra qe ka Banka.</p> <p>Blerje e ekzistueseve (ne rastet e kerkuara nga Banka)</p>	
<p>7. Tabela Exchange (ekran nga nje ane ose te dy anet)</p> <p>Perdorimi: Vertikal me stende per mbatjen e tabelës se exchange</p> <p>Komandimi: Me telekomande, e preferueshme me komandim nga qendra</p> <p>Menyra e komandimit: Bluetooth, wireless, Lan nese ka mundesine e komandimit nga qendra.</p> <p>Madhesia e tabelës (ekrani): 49" , 55"</p> <p>Permasa e tabelës bashke me bazamentin: 180cm – 200cm (lartesia) x 60cm – 70 cm (gjeresia)</p> <p>Rezolucioni: >=1920x1080 preferohet sa me i larte 2k/4k</p> <p>Informacioni i paraqitur: Kursi, tekst, foto, data, ora, logo e bankes etc.</p> <p>Kendi i shikimit: >= 165 grade</p> <p>Shikueshmeri: E dallueshme ne drite dhe kundra rrezeve te diellit mundesisht.</p> <p>Telekomanda/Programi: I perفشire ne cmimin e tabelës bashke me instalimin e tabelave ne deget e bankes sipas kerkeses.</p> <p>Tensioni i punes: 220v/50Hz</p> <p>Niveli i zhurmes: <=70db</p> <p>Kosto per njësi duhet te perفشije: TVSH, instalimin, transportin, telekomanda/ programimi sipas kerkeses nga Banka.</p>	
<p>8. Brava mekanike me celes per Kasaforta Ditore, Qendrore dhe ATM.</p>	
<p>9. Thase Lecke (gjat 80 cm, gjer: 50 cm, mbyllja me percina me rrathe nr. percinave 10)</p>	
<p>10. Lidhese sigurie me numer serial per thase te transportit monetar (gjat: 430 mm, gjer: 6mm)</p>	
<p>11. Qese per monedha metalike B5, (gjat: 195mm, gjer: 280mm)</p>	
<p>12. Lidhese sigurie me numer serial per ATM-s, (gjat: 430mm, gjer: 3mm)</p>	
<p>13. Makine shirituese kartemonedhash e vogel</p> <p>Perdorimi: Desktop tavoline</p> <p>Materiali i lidhjes: Leter dhe OPP film</p> <p>Gjatesia e letres/OPP Film: +- 150m</p> <p>Gjeresia e shiritit te letres: 40mm</p> <p>Menyra e lidhjes: Te beje te mundur fashetimin e macetave ne gjeresi</p> <p>Menyra e ngjitjes: Me nxehtesi</p> <p>Shpejtesia e Lidhjes: <2sekonda</p>	



<p>Permasat e paketimit: $\geq 80 \times 30 \text{mm}$ Shtegu i kalimit te letres: I hapur nga siper me orientim fiks nga te dyja anet Tensioni i shtrengimit: I rregullueshem nga perdoruesi Temperatura e ngjitjes: E rregullueshme nga perdoriesi nepermjet tستيرes se makines Tensioni i punes: 220v/50Hz Niveli i zhurmes: $\leq 70 \text{db}$ Kosto per njësi duhet te perfshije TVSH, instalimin, transportin sipas kerkeses nga Banka.</p>	
<p>14. Makine shirituese kartemonedhash e madhe Perdorimi: Desktop tavoline Materiali i lidhjes: Leter dhe OPP film Gjatesia e letres/OPP Film: $\pm 150 \text{m}$ Gjeresia e shiritit te letres: 40mm Menyra e lidhjes: Te beje te mundur fashetimin e macetave kryq, ne gjatesi e gjeresi Menyra e ngjitjes: Me nxehtesi Shpejtesia e Lidhjes: $< 2 \text{sekonda}$ Permasat e paketimit: $\geq 200 \times 160 \text{mm}$ Shtegu i kalimit te letres: I hapur nga siper me orientim fiks nga te dyja anet Tensioni i shtrengimit: I rregullueshem nga perdoruesi Temperatura e ngjitjes: E rregullueshme nga perdoriesi nepermjet tastieres se makines Tensioni i punes: 220v/50Hz Niveli i zhurmes: $\leq 70 \text{db}$ Kosto per njësi duhet te perfshije TVSH, instalimin, transportin sipas kerkeses nga Banka.</p>	
<p>15. Shirat Plastik per makinat shirituese (gjat: 4000 mt, gjer: 8-9mm) ngjyra blu ose e bardhe, (e printuar ose jo) per makinat ekzistuese</p>	
<p>16. Leter speciale per makinat e reja shirituese te kartemonedhave (sipas specifikimeve ne pikat 13-14).</p>	
<p>17. Llamba kontrolli UV (Ultra Violet)</p>	
<p>18. Bateri 9 Volt-she</p>	

Cmimet duhet te perfshijne TVSH-ne si dhe te gjitha kostot, taksat ose shpenzimet e tjera te nevojshme.

- Oferta juaj financiare duhet te jete **ekzaktesisht** sipas tabelës së mesiperme.

Vlerat e mesiperme te perfshijne:

- Transportin
- TVSH, cdo takse apo tatim
- Instalim, ç'instalim
- Shpenzim stafi (Kohe punëtori, Shpenzime dieta, hoteleri)

Percaktohet sa siper:

Per makinat e numerimit te kartemonedhave NC-7100 kosto per njesi duhet te perfshije: trajnimi i punonjesve te Bankes, manual perdorimi ne gjuhen shqipe, suport on-line.

Per tabelat exchange kosto per njesi perfshin telekomanda/programimi sipas kerkeses nga Banka.



ANEKSI C- SASIA E PAJISJEVE PER CDO DEGE

Dega	Llampa kontrolli UV Te ≠	Mak.Shirituese Te ≠	Tab.Exchange Te ≠	Kas,Ditore EK1500	Kas.Qendrore Te ≠	Mak.numerimi NC-7100
Volti Qendror		1			1	2
Blv.Zogu I	1	1	1	3	1	3
Qendrore			1	3	1	3
Unaza e Re		1	1	2	1	2
Premium						
Blloku				2	1	2
Autostrada	2	1	1	3	1	3
Fresku				2	1	2
21-Dhjetori				2	1	2
Parku		1	1	2	1	3
Brryli	2	1	1	2	1	4
Zogu i Zi	2	1	1	2	1	2
Kombinat	1		1	2	1	2
Pazari i Ri		1	1	2	1	2
Medrese	2		1	2	1	2
K. Parisit		1	1	2	1	2
Fier		1		3	1	3
Durres		1		2	1	3
Durres Vollga		1	1	2	1	2
Gjirokaster	2	1	1	2	1	3
Korce	1	1	1	2	1	2
Shkoder	3	1	1	3	1	3
Vlore		1	1	3	1	3
Elbasan	1	1	1	3	1	3
Sarande		1	1	2	1	2
Ksamil			1	2	1	2
Lushnje	2	1	1	2	1	2
Pogradec	1	1	1	2	1	2
Lezhe	1	1	1	2	1	2
Kamza	1	1	1	2	1	2
Kavaje	2	1	1	1	1	1
Librazhd	1		1	1	1	1
Berat			1	2	1	2
Bilisht	1		1	1	1	2
Permet	1	1	1	1	1	2
Vore	1		1	2	1	2
Lac		1	1	2	1	2
TOTAL	28	25	30	73	36	82



ANEKSI D – KERKESA DHE DOKUMENTA TE TJERA

Ju lutem, jepni detajet tuaja per sa me poshte:

➤ **Garancia:**

Materialet qe do te perdoren do te jene te reja, origjinale, sipas standarteve dhe specifikimeve teknike te kerkuara nga Banka.

Garancise te kerkuar nga Banka:

- Garancia e pajisjeve te reja kode elektronike, mekanike te jete minimum 1 vit.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per punen e kryer te jete: jo me pak se 6 muaj nga dita e venies ne pune.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per makinat e numerimit te kartemonedhave NC-7100: minimumi 2-dy vite nga venia ne pune.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per Kasafortat Ditore kosto per njesi perfshin TVSH, instalimin, transportin sipas kerkeses nga Banka: 3 vite.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per tabelat exhchange: 1-2 vite.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per Kasafortat Qendrore: minimumi 3 vite.
Ofruar nga ju: _____
- Garancia per makinat shirituese e vogel/e madhe: 1-2 vite.
Ofruar nga ju: _____

➤ **Koha e pergjigjes per Mirembajtjen On-call:**

Prezenca ne dege pas njoftimit me telefon/email, kerkuar nga Banka:

- Brenda 24 oresh per deget ne Tirane.
Ofruar nga ju: _____
- Brenda 24-48 oresh per deget ne Rrethe.
Ofruar nga ju: _____

➤ **Afati i dorezimit te produkteve pas njoftimit nga Banka:**

Kerkuar nga Banka:

- Afati i dorezimit te produkteve per materialet thase fondesh, siguresa fondesh, siguresa ATM etj: 2-3 jave nga momenti I njoftimit.
Ofruar nga ju: _____
- Afati i dorezimit per makinat e numerimit te kartemonedhave NC-7100: 1-2 muaj.
Ofruar nga ju: _____
- Afati i dorezimit per Kasafortat Ditore: 3-6 jave.
Ofruar nga ju: _____
- Afati i dorezimit per tabelat exhchange: 1-3 muaj.
Ofruar nga ju: _____
- Afati i dorezimit per Kasafortat Qendrore: 1-3 muaj.
Ofruar nga ju: _____
- Afati i dorezimit per makinat shirituese e vogel/e madhe: 1-3 muaj.
Ofruar nga ju: _____

➤ **Termet e pageses:** Periudha specifike brenda se ciles Banka duhet te paguaje shumen e detyrimeve, brenda 30 diteve nga data e marrjes se Produkteve/sherbimit. **Ofruar nga Ju:** _____

➤ **Lista e Klienteve** me te cilet ju keni bashkepunuar specifikisht per kete produkt qe ne kerkojme ose per produkte te ngjashme.

- **Konfirmoni qe dispononi te gjithe Zerat e kerkuara nga Banka: Konfirmimi juaj:** _____

- **Dokumentacion teknik dhe ligjor:**

- Fotokopje e certificates se regjistrimit si person i tatueshem nga organi perkates.
- Kopje e ekstraktit te printuar te Regjistrit tregtar nga QKR brenda muajit te fundit.
- CV e kompanise,
- Kontrata sherbimi te ngjashme. Klientet per punime te njejta apo te ngjashme me ate te kerkuar.
- Leter Reference per bashkepunim relevant me institucione/kompani private (te pakten dy).

- **Formulari vigjilences:** Plotesoni formatin bashkengjitur emailit.

ANEKSI E – DRAFT KONTRATA

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1. Objekt i kësaj kontrate është “Furnizim/mirembajtje me produkte sigurie Bankare per nevoja te Tirana Bank, në të gjithë Shqipërinë”. Në rastet kur është e nevojshme ndërrimi i pjesëve të dëmtuara me pjesë të reja, “Mirëmbajtësi” do të kryej punimet e nevojshme. Lista e detajuar e shërbimeve jepet në Aneksin 1 te kesaj kontrate.
- 1.2. Blerja dhe instalimi i makinave te numerimit me nje dhe dy xhepa, si dhe ofrimi i shërbimeve per mirembajtjen periodike dhe riparuese te tyre. Lista e detajuar e shërbimeve jepet në Aneksin 2 te kesaj kontrate.
- 1.3. Blerje Kasaforta Ditore KORAL EK1500, sipas detajeve ne Aneksin 2 te kesaj kontrate.
- 1.4. Anekset përbëjnë pjesë të pandarë të kësaj kontrate.

Neni 2

MIRËMBAJTJA

- 2.1 Mirëmbajtja që jepet në mënyrë të detajuar në Aneksin 1: “Shërbimet dhe çmimet”, do të përfshijë mirëmbajtjen periodike si dhe mirëmbajtjen riparuese, që do të përfshijë riparimin për eliminimin e problemeve, apo dëmtimeve; si dhe kryerjen e punimeve të mundëshme, sipas raportimeve nga “Banka”.

Neni 3

KOHËZGJATJA E KONTRATËS

- 3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për në periudhë dy vjeçare, duke filluar nga data 31.07.2026 per Sherbimin e mirëmbajtjes dhe Blerja dhe instalimi i makinave te numerimit me nje dhe dy xhepa, si dhe ofrimi i shërbimeve per mirembajtjen periodike dhe riparuese te tyre, dhe me 30.11.2026 per Blerje Kasaforta Ditore KORAL EK1500.
- 3.2 Kontrata do të shtyhet automatikisht me të njëjtat kushte dhe për 1 (një) vit tjetër nëse Banka nuk kërkon me shkrim përfundimin e kontrates 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të afatit.

NENI 4

ÇMIMET DHE MËNYRA E PAGESËS

- 4.1 Çmimet e shërbimeve të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Kontrate, jepen në mënyrë të datajuar në Anekset 1 dhe 2, ku përfshihet TVSH dhe të gjitha taksat dhe tatimet e detyrueshme për t’u paguar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 4.2 Pagesa do te kryhet brenda 30 diteve nga data e marrjes se produkteve, ne numrin e llogarise qe kompania ka/do te hape ne Banken Tirana. Pagesa do te behet me transferte ne llogarine numer _____.
- 4.3 Nese Ofruesi i shërbimit nuk e ka aktualisht apo nuk e ka te mundur te hape nje llogari prane Bankes, komisionet e transfertave do te jene ne ngarkim te tyre.
- 4.4 Për çdo ditë vonesë në pagesë, “Banka” penalizohet sipas kamatës ligjore në fuqi, në përputhje me Ligjin 48/2014 date 24.04.2014.
- 4.5 Çmimet do te mbeten te pandryshuara per te gjithë kohezgjatjen e Kontrates.

Neni 5

DETYRIMET E PALEVE

- 5.1 “Mirëmbajtësi” merr përsipër kryerjen e Mirëmbajtjes riparuese në vendin e caktuar sipas njoftimit nga ana e “Bankës”.
- 5.2 Gjatë kryerjes së shërbimit, “Mirëmbajtësi” do të kryejë të gjitha ato procedura që janë të nevojshme, në menyrë që materialet e përmendura në nenin 2, të ruhen në gjendje të shkelqyer funksionale.
- 5.3 Shërbimet do të kryhen gjatë ditëve dhe orëve të punës (E Hënë –E Premte 8:00 -17:00), sipas lajmërimit nga “Banka”.
- 5.4 Ofruesi i shërbimit merr persiper te siguroj te njejtat materiale zevendesuese si origjinalet.

- 5.5 "Banka" merr përsipër lehtësimin me çdo mënyrë të kryerjes së shërbimeve të përmendura në nenin 2.
- 5.6 "Banka" do të ushtroje kontroll mbi cilësinë e shërbimeve objekt i kësaj Kontrate.

Neni 6

KUSHTET E POROSISE

- 6.1. Shërbimi do të merret në dorëzim nga personat e autorizuar të "Bankës".
- 6.2. "Banka" do të verifikojë çdo shërbim të kryer nga "Mirëmbajtësi". Në verifikimin e shërbimit, objekt i kësaj kontrate, me pëlqimin e "Bankës", mund të marrë pjesë edhe perfaqësuesi/t e "Mirëmbajtësit".
- 6.3. "Mirëmbajtësi", është i detyruar që shërbimin e kryer ta shoqërojë me procesverbalin e punimeve, që do të jetë i plotësuar nga "Mirëmbajtësi" në prani të "Bankës" sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 7

GARANCIA DHE AFATI I LEVRIMIT DHE KOHA E PERGJIGJES

- 7.1. Cilësia e shërbimit, objekt i kësaj kontrate, do të jetë sipas kushteve të përcaktuara në dokumentat e kërkuara. "Mirëmbajtësin" i garanton "Bankes" se pajisjet janë të reja, të papërdorura, pa defekte dhe specifitimeve teknike të pershkuara në aneksin A, si dhe përputhen në çdo aspekt me kërkesat dhe rregullat e kërkuara dhe parashikuara për paisje të tilla.
- 7.2. "Mirëmbajtësi" i garanton "Bankes" se Pajisjet do të jenë pa defekte brenda periudhës së garancisë, që nënkupton se "Mirëmbajtësi" merr përsipër riparimin apo zëvendësimin brenda periudhës së garancisë dhe konform kushteve të garancisë.
- 7.2. "Banka" në rastet e kërkesës për shërbim, njofton "Mirëmbajtësin" menjëherë me shkrim. "Mirëmbajtësi" është i detyruar t'i përgjigjet "Bankës" me shkrim brenda të njëjtës ditë nga marrja e njoftimit dhe të nisë menjëherë procedurat e rastit.
- 7.3. Afati i garancisë duke filluar nga data e instalimit/dorëzimit, sipas procesverbalit të dorëzimit të firmosur nga "Mirëmbajtësi" dhe perfaqësuesi i Bankes do të jete sipas Aneksit C të kontratës.
- 7.4. Afati i dorëzimit dhe koha e përgjigjes do të jete sipas Aneksit C të kontratës.
- 7.5. Materialet që do të përdoren nga "Mirëmbajtësi", do të jenë të reja, origjinale dhe sipas standarteve.
- 7.6 "Mirëmbajtësi" merr përsipër të përballojë të gjitha shpenzimet në rastet e dëmeve të mundshme, si dhe transportin e mjetit të dëmtuar nga vendi i ngjarjes deri në territorin e "Bankës".

NENI 8

KONFIDENCIALITETI

- 8.1 "Mirëmbajtësi" dhe punonjësit e tij janë kategorikisht të ndaluar të kenë akses në të dhënat personale të të tretëve të mbledhura nga "Banka" gjatë aktivitetit të saj.
- 8.2 Palët janë të detyruara të ruajnë plotësisht konfidencialitetin dhe të mos u bëjnë të njohur të tretëve asnjë informacion që ato mund të marrin, si gjatë zbatimit të kësaj kontrate ashtu edhe pas përfundimit të saj.
- 8.3 Palët bien dakord që konsiderohen të fshehta dhe sekrete informacionet me gojë ose me shkrim, të dhënat, metodat, teknikat ose procedurat që ndjek Banka për planifikimin, zhvillimin dhe ofrimin e produkteve ose shërbimeve të saj si dhe çdo informacion që ka të bëjë me klientelën, veprimtarinë afariste dhe personelit që ka Banka. "Mirëmbajtësi" si dhe punonjësit e tij, janë të detyruar për mbajtjen e fshehtësisë së plotë për informacionet dhe të dhenat që bëhen të njohura për ta nëpërmjet kësaj kontrate, si gjatë periudhës së kësaj kontrate ashtu edhe pas përfundimit të saj (pa kufizim kohor), duke pasur përgjegjësi penale në bazë të Kodit Penal si dhe përgjegjësi për kompensimin e çdo dëmi që mund të shkaktohet Bankës për arsye të shkeljes së detyrimit të lartpërmendur.
- "Mirëmbajtësi" si dhe punonjësit e tij, nuk duhet të përdori informacione apo të dhëna që bëhen të njohura për ta nëpërmjet kësaj kontrate, lidhur me veprimtarinë e Bankës apo Klientëve të saj, për qëllimet e tij ose për qëllime të tjera, të shpërndaje ose të bëjë të njohur (transmetojë) informacion tek persona, shoqëri, biznese ose organizata të tjera.
- 8.4 "Mirëmbajtësi" duhet të njoftojë "Bankën" në rast cënimi të të dhënave personale të mbledhura nga kjo e fundit.
- 8.5 "Mirëmbajtësi" duhet të njoftojë Bankën menjëherë dhe pa vonesë, për çdo dëm, dëmtim ose për çdo ngjarje tjetër të jashtëzakonshme gjatë ushtrimit të shërbimit.

NENI 9

ANKIMIMET

- 9.1. Objekt ankimimi do të jetë mosrealizimi i neneve të kësaj kontrate.
- 9.2. Ankimimet do të bëhen nga "Banka" me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga data e konstatimit ose përfundimit të afatit të shërbimit.
- 9.3. "Mirëmbajtësi" brenda 5(pesë) ditëve nga marrja e njoftimit për ankim ndaj shërbimit, duhet të paraqitet pranë "Bankës", për të saktësuar dhe zgjidhur objektin e Ankimit në të kundërt mbetet në fuqi ankimimi i "Bankës".

NENI 10

KLAUZOLA KUNDER RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT

- 10.1. "Mirëmbajtësi" angazhohet se nuk do të marre, nuk do të ofroje, premtaje ose do të japë ndonjë përfitim financiar ose të ndonjë lloji tjetër, që nuk është i detyrueshem sipas praktikave me të mira tregtare apo kushteve kontraktuale, drejtperdrejt ose terthorazi për ndonjë person ose subjekt të lidhur apo jo me Bankën, në këmbeje që ata të veprojnë ose të mos veprojnë në kundërshtim me përmbushjen e detyrave të tyre për t'i mundësuar "Mirëmbajtësi" lidhjen dhe/ ose përmbushjen e kesaj Kontrate.

NENI 11

TERHEQJA NGA KONTRATA

- 11.1. Secila palë mund të tërhiqet nga kontrata, në qoftë se pala tjetër shkakton shkelje themelore të saj që janë:
 - 11.1. a. "Banka" konstaton se:
 - "Mirëmbajtësi" nuk plotëson kërkesat cilësore të shërbimit.
 - "Mirëmbajtësi" vonon shërbimin, tej afateve të përcaktuara në kontratë.
 - "Mirëmbajtësi" nuk është në gjendje të përmbushë në rregull, detyrimet kontraktore.Në rast se kontrata zgjidhet nga "Banka" për shkaqet e përmendura në paragrafet e 12.1.a, "Mirëmbajtësi" është i detyruar t'i paguaj "Bankës" një penalitet në masën prej 5 % të vlerës së shlyer të kontratës.
 - 11.1.b. "Mirëmbajtësi" mund të tërhiqet nga kontrata kur "Banka" nuk kryen në afat, pagesat për shërbimin e ofruar dhe të marrë në dorëzim prej tij, edhe kur cilësia e këtij të shërbimi ka qenë në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara në dokumentat e kërkuara.
- 11.2 Kontrata do të quhet e zgjidhur për shkaqet e përmendura në paragrafin 12.1 mësipër, nëse pala që ka shkelur kushtet e kontratës nuk i përmbush plotësisht ato brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që ka marrë njoftimin e palës tjetër lidhur me konstatimin e këtyre shkeljeve dhe detyrimin e saj (palës që ka shkelur kontratën) për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për ndreqjen e tyre brenda afatit 30 ditor të njoftimit.
- 11.3 Pala mund të kërkojë në çdo kohë, zgjidhjen e kësaj kontrate, duke e lajmëruar me shkrim palën tjetër 60 ditë kalendarike më përpara.

NENI 12

FORCAT MADHORE

- 12.1. "Mirëmbajtësi" nuk e humbet garancinë e realizimit të kontratës kur mosrespektimi i detyrimeve të kontratës është rezultat i një Force Madhore.
- 12.2. Do të konsiderohet Forcë Madhore çdo ngjarje që ndodh jashtë kontrollit të "Mirëmbajtësit" dhe nuk përbën gabim apo neglizhencë nga ana e "Mirëmbajtësit" dhe që nuk mund të parashikohet. Këtu bëjnë pjesë luftrat, zjarret, përmytjet, tërmetet, epidemitë, embargot.
- 12.3. "Mirëmbajtësi" duhet që të njoftojë me shkrim "Bankën" për shfaqjen e fenomenit të Forcës Madhore.

NENI 13

TE PERGJITHSHME

- 13.1. Nëse ndonjë nga termat e parashikuara nga kjo kontratë, gjykohet në kundërshtim me legjislacionin shqiptar që është aktualisht në fuqi ose do të jetë në të ardhmen gjatë kohëzgjatjes së kontratës, ato do të konsiderohen si të pavlefshme.

NENI 14

ZGJIDHJA E MOSMARVESHJEVE

- 14.1. Të dy palët do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur në mënyrë paqësore nëpërmjet bisedave të drejtpërdrejta çdo mosmarveshje që lind midis tyre për Kontratën. Në rast të kundërt, secila palë mund t'i drejtohet



gjykatës. Vendi i gjykimit është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

14.2. Kjo kontratë u perpilua në 2 kopje nga të cilat, një kopje e merr “Mirëmbajtësi” dhe një kopje e mban “Banka”.

